



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE  
Drejtoria e Kthimit të Pronave  
*Spektori i Apelimit*

“Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, Kulla Binjake nr.2, Tiranë

Tel / Fax ++355 4 256 831 / 15

**VLERËSIM LIGJOR**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 37 PROT, DATË 09.03.2007,  
ME OBJEKT KUNDËRSHTIMIN E VENDIMIT NR. 58, DATË 08.01.1997 TË KKKP  
VLORË**

**DHE**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 187 PROT, DATË 14.04.2005,  
ME OBJEKT ANULLIMIN E VENDIMIT NR.58, DATË 08.01.1997 TË KKKP VLORË.**

Nr.....Prot

Datë \_\_\_\_ .03.2007

Drejtuar: Drejtorit të Pëgjithshëm  
Zj. Justina BORIÇI

**TË DHËNA**

---

**Kërkesa nr.37 prot, datë 09.03.2007.**

**Kërkues :** Avokati i Shtetit, përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm Artan Kodheli dhe Sekretari i Përgjithshëm Avenir Peka.

**Objekti :** Kundërshtim i Vendimit nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë, dhënë në favor të subjektit Leko HODAJ.

**Baza Ligjore:** Neni 2 pika 1 e ligjit nrr.9684, datë 06.02.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

---

**Kërkesa nr. 187 prot, datë 14.04.2005.**

**Kërkues :** Bashkia Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Shpëtim Gjika.

**Objekti :** Kundërshtim dhe anullim i Vendimit nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë, dhënë në favor të subjektit Leko HODAJ.

**Baza Ligjore:** Neni 16, pika 2 e ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

---

## Zj. Drejtoreshë e Përgjithshme,

Me Vendimin nr.58, datë 08.01.1997, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Vlorë, ka kompensuar fizikisht me tokë truall subjektin **Leko Hodaj** me një sip. prej 11.025 (njëmbëdhjetëmijë e njëzetepesë) m<sup>2</sup>, *tokë truall*, i cili ndodhet në Gjirin e Vlorës e konkretisht në territorin e ish-Uzinës të Sod PVC-së, me këto kufizime: **Veriu**.Territori i Uzinës Sod PVC, **Jugu**. Ranishte, **Lindje**. Ranishe, **Perëndim**. Pylli i Pishës.

1. **Më datë 14.04.2005** Bashkia Vlorë ka paraqitur kërkesën ankimore pranë Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e administruar me nr.187 prot, datë 14.04.2005.

Me anë të kësaj kërkesë ankimore **kundërshtohet dhe njëkohësisht kërkohet anulimi i gjashtë vendimeve, për kompensim fizik me truall, të dhëna nga KKKP Vlorë**, një prej të cilëve është edhe **Vendimi nr.58, datë 08.01.1997, i KKKP Vlorë objekt i këtij shqyrtimi**.

Bashkia Vlorë në këtë kërkesë ankimore argumenton cënimin e interesave të ligjshme të Shtetit Shqiptar nga dhënia e këtij vendimi dhe konkretisht:

- *Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9231, datë 13.05.2004 ka ratifikuar Marrëveshjet e Koncesionit të formës BOO dhe BOT, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar dhe infrastrukturës përkatëse portuale ne Gjirin e Vlorës, për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj nga shoqëria konçesionare La Petroifera Italo-Rumena Srl.*
- *Një nga detyrimet e marrëveshjeve është edhe dorëzimi i zonës dhe nënshkrimi i kontratës së shitjes për kalimin e pronësisë së truallit tek Koncesionari La Petroifera, për sipërfaqen e tokës prej 183.000 m<sup>2</sup> e caktuar për ndërtimin e Terminalit dhe infrastrukturës përkatëse, pasi shoqëria La Petroifera të kishte dorëzuar projektin përfundimtar.*
- *Transferimi i pronësisë dhe dorëzimi i zonës së konçesionit pengohet nga rregjistrimi i gjashtë vendimeve të KKKP Vlorë në ZVRPP, ku njeri prej tyre është edhe **Vendimi nr.58, datë 08.01.1997**.*

Kërkesa për rishikimin dhe anulimin e këtij vendimi është paraqitur nga Bashkia Vlorë me shkresë **nr.992, datë 13.04.2005**, në mbështetje të **nenit 16, pika 2 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”**, dispozitë kjo e cila legjitimonte edhe organet e qeverisjes vendore për paraqitjen e ankimeve në KSHKKP. Në këtë dispozitë konkretisht citohet :

*”Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave verifikon vendimet e komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave, të ngritura sipas ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Kërkesa për verifikimin e vendimeve të dhëna paraqitet në mënyrë të motivuar **nga organet e qeverisjes vendore** ose subjektet e shpronësuar brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Komiteti ka të drejtë të shfuqizojë vendimin administrativ të dhënë ose të kërkojë shfuqizimin e tij në rrugë gjyqësore.*

Pavarësisht nga sa më sipër, nga praktikat e ndodhura pranë KSHKKP-së, rezultoi që ky i fundit nuk është shprehur me vendim për këtë kërkesë.

Tashmë shqyrtimi i këtij ankimi bazuar edhe në ligjin nr.9684, datë 06.02.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të

ndryshuar, dhe konkretisht në nenin 3 të tij, është në kompetencë të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si më poshtë citojmë:

*“Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, për vendimet e ish-komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe **ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve**, të ankimura dhe të depozituara në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, para krijimit të AKKP-së, **të mbetura pa shqyrtuar**, shprehet me vendim brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.*

2. Më datë 09.03.2007 Institucioni i Avokaturës së Shtetit, i cili në mbështetje të ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 “Për avokaturën e shtetit”, mbron dhe përfaqëson interesat e shtetit në Gjykimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, ka paraqitur kërkesën ankimore në AKKP të administruar me nr.37 prot, datë 09.03.2007. Me anë të saj kërkohet, kundërshtimi i gjashtë vendimeve, për kompensim fizik me truall, të dhëna nga KKKP Vlorë, ku njëri prej tyre është edhe **Vendimi nr.58, datë 08.01.1997**, i KKKP i ngritur pranë Këshillit të Rrethit Vlorë, objekt i këtij shqyrtimi, i cili ka kompensuar fizikisht me tokë truall me sip. prej 11.025 m<sup>2</sup>, **subjektin Leko Hodaj**, në Gjirin e Vlorës e konkretisht në territorin e ish-Uzinës të Sod PVC-së.

Sipas kërkesës ankimore të Avokaturës së Shtetit, ky institucion është duke mbrojtur shtetin shqiptar në çështjen me palë paditëse shoqërinë konçesionare “La Petrolifera” në Dhomën e Arbitrazhit Ndërkombëtar në Paris.

Ky konflikt ka ardhur si rezultat i moszbatimit të kontratës së konçesionit dhe konkretisht mosdorëzimit të zonës së konçesionit nga shteti shqiptar tek shoqëria konçesionare “La Petrolifera”. Kjo zonë është rregjistruar në rregjistrat e ZRPP-së në emër të shtetit me VKM nr.95, datë 11.02.2005, “Për regjistrimin e pronës së paluajtshme, në emër të Republikës së Shqipërisë, të truallit në Gjirin e Vlorës, dhënë me konçesion Shoqërisë “La Petrolifera Italo Albanese” (“PIA”).

Siç përmendëm edhe më lart nga hetimet e kryera nga Avokatura e Shtetit, shkak për mospërmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar sipas marrëveshjes së konçesionit, janë bërë dhënia e gjashtë vendimeve të kompensimit fizik nga KKKP Vlorë dhe rregjistrimi i tyre në ZRPP Vlorë, të cilët sipas Avokaturës së Shtetit janë vendime të kundraligjshme. Konkretisht këto vendime janë :

1. **Vendimi nr.39, datë 4.2.1997, KKKP Vlorë**, i cili ka kompensuar fizikisht me tokë truall **subjektin Kristaq Gjergji** me një sip. **8817 m<sup>2</sup>** .
2. **Vendimi nr.42, datë 8.2.1997, KKKP Vlorë**, i cili ka kompensuar fizikisht me tokë truall **subjektin Zyk Zykaj** me një sip.**11221 m<sup>2</sup>**.
3. **Vendimi nr.59, datë 18.2.1997, KKKP Vlorë**, i cili ka kompensuar fizikisht me tokë truall **subjektin Kaçandone Mustafaraj**, me një sip. prej **9700 m<sup>2</sup>**.
4. **Vendimi nr.60, datë 8.2.1997, KKKP Vlorë**, i cili ka kompensuar fizikisht me tokë truall **subjektin Nxhiko Shyti** me një sip. **9292 m<sup>2</sup>**.
5. **Vendimi nr.61, datë 8.2.1997, KKKP Vlorë**, i cili ka kompensuar fizikisht me tokë truall **subjektin Kadëna Stepa** me një sip. **9132 m<sup>2</sup>**.
6. **Vendimi nr.58, datë 8.1.1997, KKKP Vlorë**, i cili ka kompensuar fizikisht me tokë truall **subjektin Leko Hodaj** me një sip. **11 025 m<sup>2</sup>**, **objekt i këtij shqyrtimi.**

Kërkesa ankimore e paraqitur nga Avokatura e Shtetit është e bazuar në ligjin nr.9684, datë 06.02.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, ligj ky i cili ka parashikuar legjitimitimin e Avokaturës së Shtetit, si palë ankuese gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, konkretisht në nenin 2, pika 1 të këtij ligji, ku shprehimisht citohet :

*“Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të zyrës rajonale të AKKP-së në qark, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, në zyrën e AKKP-së në qendër. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim në zyrën e AKKP-së në qendër. Jo më vonë se 30 ditë nga regjistrimi i ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së merr vendim për objektin e ankimit.”*

Avokatura e Shtetit në mbrojtje të interesave shtetërore, ka kërkuar shfuqizimin e gjashtë vendimeve të mësipërme, dhënë nga KKKP Vlorë, ku ndërmjet tyre edhe **Vendimi nr.58**, datë 08.01.1997, objekt i këtij shqyrtimi, duke i vlerësuar këto vendime të kundraligjshme me argumentat e mëposhtëm:

1. Vendimet janë të dyshimtë nga ana e kolegjalitetit të marrjes së vendimit, ekzistencës së provave në dosje dhe protokollimit të tyre. Firmat e anëtarëve të komisionit janë të dyshimta. Nuk ekzistojnë dosjet përkatëse në arkivën e KKKP Vlorë. Ka kontradiktë në numrat e vendimeve, si psh. **Vendimi nr.58**, rezulton të jetë marrë më datë 08.01.1997, ndërsa **Vendimi me nr.42**, daton më 08.02.1997 dhe **Vendimi nr.39**, daton më 04.02.1997 . Kjo mungëse e renditjes sipas numrit rritës me kalimin e datave, të çon në konkluzionin se këto vendime nuk janë marrë sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara, në aktet nënligjore për funksionimin e KKKP, çka i bën këto vendime të pavlefshme.
2. Vendimet nga ana materiale, janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me kompensimin fizik të ish-pronarëve.
  - Baza ligjore e përdorur për këto vendime nuk i jep të drejtë KKKP Vlorë të bënte kompensim fizik, të ish-pronarëve, ç’ka nënkupton se këto akte janë marrë në kapërcim të kompetencave që ka patur ky institucion dhe për rrjedhojë janë absolutisht të pavlefshëm dhe nuk mund të sjellin asnjë pasojë juridike. VKM nr.560, datë 16.10.1995 nuk mund të shërbente si mbështetje ligjore për aplikimin e kompensimit fizik të ish-pronarëve, pasi vetë kjo VKM titullohet “Për masat për zbatimin e ligjit “për kompensimin në vlerë të ish-Pronarëve”. Në çdo dispozitë të kësaj VKM-je nuk parashikohet asnjë element ligjor për mënyrën se si do të bëhet kompensimi dhe se kush do të jetë organi që do të realizojë këtë kompensim fizik. Ligji nr.7980 i përdorur si bazë ligjore në fund të këtyre vendimeve nuk ka aspak lidhje me kompensimin fizik të ish-pronarëve por me shitblerjen e trojeve.
  - Procedurat konkrete për kompensimin në natyrë të ish-pronarëve të tokave bujqësore kanë filluar me ligjin nr.8084, datë 07.03.1996 dhe VKM nr.528, datë 13.05.1996. Ky ligj parashikon potencialisht kompensimin fizik të ish-pronarëve me troje në zonat turistike, e cila teknikisht rregullohet me VKM nr.528, datë 13.05.1996. Ky vendim parashikon një sërë procedurash që nuk janë zbatuar nga KKKP i Këshillit të Rrethit Vlorë dhe që i bëjnë këto vendime absolutisht të pavlefshme.
- a) Nuk është zbatuar pika 4, e VKM nr.528, datë 13.05.1996, pasi nuk rezulton të ketë studim të KRTRSH, për përcaktimin e parcelave për kompensim fizik.

- b) Nuk rezulton të jetë zbatuar pika 5, e VKM së mësipërme, për radhën e kompensimit të ish-pronarëve.
- c) Nuk është zbatuar drejt çmimi i tokës që kompensohet. Në bazë të pikës 6, të VKM nr.528, datë 13.05.1996, ky çmim është 3200 lekë dhe jo 320 lekë si në vendimet e KKKP-së Vlorë.
- d) Nuk është zbatuar pika 9 e VKM nr.528, datë 13.05.1996 për krijimin e komisionit të kompensimit fizik, në rreth, i cili drejton mbi bazën e procedurave të caktuara gjithë procesin e kompensimit fizik. Është ky komisioni (KKF) që ka të drejtë të kryejë kompensimin fizik dhe jo KKKP pranë Këshillit të Rrethit.
- e) Nuk është zbatuar masa e kompensimit fizik, e cila në asnjë rast nuk mund të jetë më shumë se 5000 m<sup>2</sup>.
- f) Nuk është zbatuar sistemi i shortit për fituesit e së drejtës së kompensimit fizik, siç parashikon VKM-ja nr.528, datë 13.05.1996.

Mbështetur në këto rrethana, Avokatura Shtetit i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, zgjidhjen në themel të çështjes duke shfuqizuar vendimet e sipërcituara , të ish-KKKP pranë Këshillit të Rrethit Vlorë.

Duke qënë se ankimimi i paraqitur nga Avokatura e Shtetit ka të njëjtin objekt si edhe ai i paraqitur nga Bashkia Vlorë si edhe duke konsideruar se tashmë Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është kompetente për shqyrtimin e tyre në këtë rast kërkesat ankimore do të trajtohen sëbashku pasi kanë të njëjtin objekt.

Duke shqyrtuar të gjitha faktet e mbledhura dhe gjithë provat e paraqitura nga Avokatura e Shtetit, konstatojmë këto,

### **RRETHANA TE ÇËSHTJES**

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9231, datë 13.05.2004 ka ratifikuar Marrëveshjet e Konçesionit të formës BOO dhe BOT, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar dhe infrastrukturës përkatëse portuale në Gjirin e Vlorës, për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj nga shoqëria koncesionare La Petrolifera Italo-Rumena Srl.

Një nga detyrimet e marrëveshjes është edhe dorëzimi i zonës dhe nënshkrimi i kontratës së shitjes për kalimin e pronësisë së truallit tek Koncesionari La Petrolifera, për sipërfaqen e tokës prej **183.000 m<sup>2</sup>** e caktuar për ndërtimin e Terminalit dhe infrastrukturës përkatëse. Për këtë qëllim, Këshilli i Ministrave, në bazë të procedurave përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit,” dhe në ligjit nr. 7843, datë 17.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme,” ka miratuar Vendimin nr.95, datë 11.02.2005, “Për regjistrimin e pronës së paluajtshme, në emër të Republikës së Shqipërisë, të truallit në Gjirin e Vlorës, dhënë me konçesion Shoqërisë “La Petrolifera Italo Albanese” (“PIA”).

Ky vendim ka ngarkuar Ministrin e Ekonomisë dhe Kryeregjistruesin e Pasurive të Paluajtshme të Republikës të kryejnë regjistrimin e Zonës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë (ZRPP Vlorë).

Në zbatim të këtij vendimi u krye rregjistrimi i zonës së koncesionit në emër të Republikës së Shqipërisë **me nr. pasurie 39/45 me sip. 183.000 m<sup>2</sup>**, e cila ndodhet në zonën kadastrale nr.8604. Në kartelën e pasurisë së paluajtshme e cila shoqëron Çertifikatën e pronësisë, regjistruesi i Vlorës në seksionin “E” ka bërë shënimin që kjo pasuri, “Zona e regjistruar në emër të Republikës së Shqipërisë” ka mbivendosje me pasuritë nr. 36/75, 39/41, 39/40, 39/37, 39/38 dhe 39/43,” të cilat janë regjistruar më parë në emër të gjashtë personave fizikë .

Në këtë mënyrë vendosja e këtij shënimi në kartelën shoqëruese të Çertifikatës, ka penguar kalimin e pronësisë së Zonës nga Shteti shqiptar tek PIA, në përmbushje të Marrëveshjeve të Konçesionit BOO dhe BOT, duke shkaktuar kështu shkeljen e detyrimeve kontraktuale nga ana e Shtetit shqiptar.

Nga hetimet e kryera nga Avokatura e Shtetit dhe Bashkia Vlorë rezulton se pengesë për moszbatimin e kësaj marrëveshje janë bërë disa pasuri të cilat e kanë origjinën e tyre nga gjashtë vendime të dhëna nga KKKP Vlorë në vitin 1997 me një sip. totale prej 59.187 m<sup>2</sup>. Ky ka qenë dhe shkaku i ligjshëm që Avokatura e Shtetit dhe Bashkia Vlorë, kanë paraqitur ankimmimet e tyre, për anulimin e gjashtë vendimeve të KKKP Vlorë, ku njëri prej tyre është edhe **Vendimi nr.58, datë 08.01.1997**, dhënë në favor të **subjektit Leko Hodaj**, objekt i këtij shqyrtimi.

Lidhur me kërkesën ankimore të Bashkisë Vlorë, ish-KSHKKP për ankesën nr.187, datë 14.04.2005 i ka kërkuar KVKKP Vlorë sqarim dhe informacion për vendimin e ankimuar nr.58, datë 08.01.1997. Komisioni Vendor i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Vlorë, me shresë nr.1336 prot, datë 08.06.2006, ka kthyer përgjigje ku ka konfirmuar se: **“Vendimi 58, datë 08.01.1997, i përket dosjes nr.69, në emër të Leko Hodaj, e cila gjendet e regjistruar në indeksin e tokë bujqësore, por rezulton dosje e djegur”**.

Tashmë Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë në shqyrtim të këtij ankimi, me shkresë nr.37/2, datë 13.03.2007, i ka kërkuar Zyrës Rajonale të AKKP-së Vlorë, informacion dhe tërheqje dosje për vendimin e ankimuar nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë.

Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Qarku Vlorë, me shresë nr.876 prot, datë 13.03.2007, ka kthyer përgjigje ku ka konfirmuar se, **“Në arkivin tonë nuk figurojnë dosje të hapura në emër të Zyke Zykaj, Kacandone Mustafaraj, Nxhiko Shyti, Leko Hodaj, Kadëna Stepa e Kristaq Gjergji gjatë vitit 1996”**. Gjithashtu kjo zyrë konfirmon në pikën 5 se: **“Duke parë dhe rregjistrat e asaj periudhe nuk na rezulton të ketë vendime në datat e paraqitura, në shkresën tuaj”**, pra në datën 08.01.1997, kur është dhënë vendimi nr.58.

Bazuar në aktet dhe shkresat e mësipërme mund të pretendojmë që kemi të bëjmë me një vendim aspak të rregullt nga ana proceduriale e dokumentimit të tij, përse i përket formës dhe procedurës së kërkuar nga ligji, apo me një vendim të fallsifikuar që nuk është nxjerrë nga KKKP Vlorë.

Duke mos patur informacionin e kërkuar për Vendimin nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP-së Vlorë apo dosjen përkatëse mbi bazën e së cilës ky vendim është dhënë, mund të gjykojmë vetëm mbi dokumentacionin e dhënë nga ZVRPP Vlorë, e administruar në KSHKKP me nr.715, datë 13.07.2006, e cila ka dërguar një kopje të njehsuar me kopjen origjinale të dokumentave që disponon kjo zyrë, dhe konkretisht ka paraqitur këto dokumenta:

- a) Vërtetim pronësie lëshuar nga Zyra e Hipotekës Vlorë, më datë 23.11.1998 me anën e të cilit vërtetohet se në favor të shtetasit Leko Hodaj në bazë të Vendimit nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP, u rregjistrua në hipotekë pasuria në kompensim të një sip. prej 11.025 m<sup>2</sup>, të ndodhur në territorin e ish-Uzinës Sodë-PVC me kufizimet përkatëse. Kjo pasuri u rregjistrua në regjistrin e transkriptimeve të hipotekës me nene 1674, datë 23.11.1998. 1 (një) fletë.
- b) Vendimin nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë 1 (një fletë).
- c) Tabelë Nr. 1 e përllogaritjeve. 1 (një) fletë.
- d) Plani i sheshit në shkallën 1 : 2000. 1 (një) fletë.

Nga studimi i përmbajtjes së Vendimit nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP-së Vlorë, rezulton se subjekti Leko Hodaj, nuk ka qenë ish-pronar në këtë zonë, pasi pronar i vetëm i saj ka qenë shteti dhe vendimi në fjalë është vendim kompensimi në natyrë pra me një sip. 11.025 m<sup>2</sup> truall në pronësi të shtetit, gjë e cila është bazuar në ligjin nr.7699, datë 21.04.1993 “Për kompensimin në vlerë ose me troje të ish-pronarëve të tokave bujqësore, kullotave, livadheve tokave pyjore dhe pyjeve”.

**Nga shqyrtimi i praktikave të administruara konstatojmë këto shkelje të dispozitave materiale dhe proceduriale, të cilat po i trajtojmë, si më poshtë:**

**Së pari**, Vendimi nr.58, datë 08.01.1997 i KKKP Vlorë, është dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve i ngritur pranë Këshillit të Rrethit Vlorë. Ky vendim është dhënë në bazë të ligjit nr.7699, datë 21.04.1993 “Për kompensimin në vlerë ose me troje të ish-pronarëve të tokave bujqësore, kullotave, livadheve tokave pyjore dhe pyjeve”, dhe në kohën e dhënies së këtij vendimi ky ligj kishte pësuar ndryshimet përkatëse dhe konkretisht ndryshimin e tij bazë me ligjin nr.8084, datë 07.03.1996 “Për miratimin me disa shtesa e ndryshime të dekretit nr.1359, datë 05.02.1996 “Për disa ndryshime në dekretin nr.1254, datë 19.10.1995 “Për kompensimin e ish-pronarëve të tokës bujqësore dhe të trojeve të zëna, me troje në zonat turistike dhe në qendrat e banuara”, ndryshuar me ligjin nr.8024, datë 02.11.1995”.

Me anën e këtij ndryshimi në ligj, u bë e mundur që ish-pronarët të kompensoheshin edhe me troje në zona turistike, përveç kompensimit në vlerë (obligacione). Në zbatim të këtij ndryshimi pra ligjit nr.8084, datë 13.05.1996, si dhe për të bërë të mundur zbatimin në praktikë të procesit të kompensimit me troje në zonat turistike, Këshilli i Ministrave miratoi **Vendimin nr.528, datë 13.05.1996** “Për masat e zbatimit fizik të kompensimit me troje në zonat turistike, në zbatim të ligjit nr.8084, datë 07.03.1996”.

Në këtë vendim përcaktoheshin edhe strukturat përkatëse që do të ngriheshin për realizimin e procesit të kompensimit fizik, si një proces i veçantë nga ai i kompensimit financiar, apo nga ai i njohjes së pronësisë dhe kthimit të pronës.

Konkretisht në **pikën 8**, të vendimit të mësipërm citohet: *“Pranë Këshillit të Ministrave caktohet i ngarkuari për ndjekjen e kompensimit fizik të ish-pronarëve”.*

Në **pikën 9** të po këtij vendimi përcaktohet se *“Me vendim të Këshillave të Rretheve krijohen **Komisionet e Kompensimit Fizik,(KKF)** në të gjitha rrethet e vendit, ku ndodhet toka që jepet për kompensim në zonën turistike”.*

Pra Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.528, datë 13.05.1996, vendosi të krijojë një organ administrativ të posaçëm, i cili do të kishte si objekt të punës së tij, **vetëm dhënien apo shpërndarjen e kompensimit fizik**. Duke studiuar **Vendimin nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë**, konstatojmë se, kompensimi me truall për subjektin **Leko Hodaj** është dhënë nga **Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP)**, ndërkohë që sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.528, datë 13.05.1996, kjo është një kompetencë lëndore të cilën ky i fundit, ia kishte njohur vetëm **Komisionit të Kompensimit Fizik,(KKF)**, i cili kishte strukturë më vehte dhe për më tepër funksiononte edhe me vulë të veçantë, ç’ka ka qënë e parashikuar në **pikën 11 të VKM nr.528, datë 13.05.1996** “Për masat për zbatimin fizik të kompensimit me troje në zonat turistike, në zbatim të ligjit nr.8084, datë 07.03.1996”, në të cilën citohet : **“Komisioni shtetëror i kompensimit fizik, si dhe ai i rretheve do të operojnë me vulë të veçantë”**, ndryshuar me VKM nr.849, datë 09.12.1996, ku në pikën 7, të tij citohet **“Komisioni shtetëror i kompensimit fizik në rrethe do të operojë me vulë të veçantë”**.

Nga sa më sipër konstatohet se, Vendimi i ankimuar nr.58, datë 08.01.1997, mban vulën e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP).

Edhe sipas përmbatjes së elementëve të identifikimit të organit që nxjerr aktin, rezulton se ky është një vendim i marrë nga KKKP dhe jo nga KKF. Pra rezulton e provuar se Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i ngritur pranë Këshillit të Rrethit Vlorë, në dhënien e vendimit nr.58, datë 08.01.1997, ka vepruar tërësisht në kapërcim të kompetencave të veta, të cilat janë të përcaktuara në një tjetër akt normativ të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht në VKM nr.560, datë 16.10.1995 "Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699, datë 21.04.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore".

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përveç njohjes të së drejtës së pronësisë dhe kthimit të saj, ka patur në kompetencë vetëm njohjen apo dhënien e kompensimit **në vlerë** dhe jo atë të kompensimit në truall, ç'ka ishte objekt pune dhe kompetencë e një tjetër organi administrativ që ishte "**Komisionit të Kompensimit Fizik**".

Ky i fundit ishte një organ i cili në zbatim të VKM nr.528, datë 13.05.1996, të ndryshuar, ngrihej në çdo rreth ku ndodhej prona e cila do të përdorej për kompensim fizik, me troje në zona turistike, por kishte varësinë nga Këshilli i Ministrave me anën e një të ngarkuari me punë që posaçërisht do të mbikqyrte dhe do të raportonte këtë proces më vehte nga procesi i kthimit të pronës apo kompensimit të saj në vlerë monetare (obligacione).

Në këto kushte, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ka vepruar në kundërshtim flagrant me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, pasi kompetencat e organeve të Administratës Publike janë të përcaktuara me ligj ose akt nënligjor dhe ushtrimi i tyre është i detyrueshëm. Pra sipas parimit kushtetues të ligjshmërisë, çdo organ administrativ është kompetent në fushën që ai mbulon dhe nuk mund të ushtrojë të drejtat e një organi tjetër, pasi ushtrimi përtej kufijve të ligjit përbën cënim të parimit të mësipërm dhe si rrjedhojë **çdo veprim** apo **akt administrativ** që mund të nxirret nga kjo veprimtari e kufizuar dhe arbitrare çon domozdoshmërisht në pavlefshmëri juridike të tyre.

Në këtë rast Vendimi nr.58, datë 08.01.1997 i KKKP Vlorë është marrë në kapërcim të kompetencave të tij dhe në këtë mënyrë në zbatim të nenit 116 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, ekzitojnë kushtet e mjaftueshme ligjore, që AKKP të konstatojë dhe të deklarojë këtë akt si absolutisht të pavlefshëm.

**Së dyti**, në Vendimin nr.58, datë 08.01.1997, KKKP Vlorë është referuar dhe bazuar në VKM nr.560, datë 16.10.1995 "Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699, datë 21.04.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore".

Ky vendim i Këshillit të Ministrave përcaktonte procedurat konkrete për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kompensimin në vlerë të tokave ish pronarëve. Edhe sikur ky komision të kishte trajtuar kërkesën e ish-pronarit për kompensim në vlerë, përsëri ai ka vepruar në kundërshtim me **pikën 4 të VKM 560, datë 16.10.1995**, ku përcaktohej se, **komisionet kanë për detyrë parësore njohjen e pronësisë dhe masën e kompensimit të saj**.

Në rastin konkret në Vendimin nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP-së Vlorë, **nuk është kryer njohja e pronësisë, por komisioni ka kaluar direkt në njohjen e së drejtës së kompensimit**, ç'ka tregon edhe një herë kundraligjshmërinë në dhënien e këtij vendimi.

Lidhur me këtë procedurë (njohjen e pronësisë) ekziton lidhja direkte midis një vendimi të KKKP-së, për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe trajtimin e një kërkesë që do të bënte Komisioni i Kompensimit Fizik. Kjo sepse, në VKM nr.528, datë 13.05.1996 **pika 9, gërma "e"**, ku parashikohet se një nga detyrat e **Komisionit të Kompensimit Fizik është** : "***Kur dyshojnë në dokumentacionin e sjellë nga ish-pronarët, kanë të drejtë të bëjnë verifikimin me kopjet e ndodhura në dosjet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave***". Pra për një pronë të një ish-pronari, për të cilën aplikohet për kompensim fizik me truall në zonat turistike, duhej që më parë të njihej e drejta e pronësisë mbi të, nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të

Pronave (KKKP), e më pas subjekti i interesuar duhej të aplikonte në Komisionin e Kompensimit Fizik (KKF), për të bërë të mundur kështu shqyrtimin e kërkesës së tij, për kompensim fizik me truall në zonat turistike. Një detyrim i tillë ka qenë e parashikuar edhe në gërmën “g”, të pikës 9, të VKM nr.528, datë 13.05.1996, ku citohet shprehimisht : “Personat e interesuar duhet të paraqesin pranë komisionit përkatës (KKF), - Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve” .

Pra edhe nëse Vendimi nr.58, datë 08.01.1997 do të ishte dhënë nga **Komisioni i Kompensimit Fizik (KKF)**, përsëri do të konsiderohej si një vendim i marrë në shkelje të rëndë me ligjin dhe procedurën e përcaktuar për kryerjen e tij, pasi nuk është kryer më parë njohja e së drejtës së pronësisë për subjektin Leko Hodaj nga KKKP e rrethit Vlorë.

**Së treti**, në Vendimin nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë, nuk sqarohet por as edhe përciptazi nuk trajtohet, nëse prona objekt i këtij kompensimi fizik është pronë shtet, apo e miratuar nga KRRTRSH për parcelë zonë turistike me qëllim për t’u përdorur për kompensim fizik, detyrim ky i parashikuar në pikën 4 të VKM 528, datë 13.05.1996 ku përcaktohet se: “Kompensimi i ish-pronarëve (ose trashëgimtarëve të tyre) me troje në zona turistike bëhet mbi bazë të studimeve urbanistike të posaçme, të cilat miratohen nga KRRTRSH”.

Nisur nga pika 4 të VKM 528, datë 13.05.1996 dhe nga shqyrtimi i vendimit nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë, objekt shqyrtimi nuk përmendet ekzistenca ose jo e ndonjë studimi të posaçëm urban të miratuar nga KRRTRSH për përcaktimin e zonave turistike ku do të aplikohet kompensimi fizik me truall.

I vetmi studim i miratuar nga KRRTRSH-ja është ai me anën e të cilit është realizuar dhënia me koncesion shoqërisë “La Petroifera”, pasi nëse një vendim tjetër i KRRTRSH-së, do të kishte ekzistuar atëherë do të kishim përplasje midis tyre, gjë e cila do të detyronte OSHA-në, Organin Shtetëror të Autorizuar, në të cilën bënte pjesë dhe Ministria Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, të trajtonte apo ngrinte këtë situatë.

Duhet theksuar fakti se KRRTRSH, nuk mund të miratonte studime për kompensime fizik me troje në zona turistike, kur ndërkohë zona e cila e dhënë me koncesion nuk është përcaktuar me destinacion të tillë (turizmin), pasi është fare pranë dhe prek ish-Uzinën e Sod-PVC-së Vlorë.

Pra edhe nëse Vendimi nr.58, datë 08.01.1997, do të ishte dhënë nga organi kompetent (KKF), përsëri kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të proceduriale, ku konkretisht pa u përcaktuar parcelat për kompensim fizik me vendim KRRTRSH-je është kryer dhënia e trojeve si kompensim fizik.

**Së katërti**, siç konstatojmë në rastin konkret me vendimin nr.58, datë 08.01.1997 kompensimi për subjektin Leko Hodaj është trajtuar në një fazë të vetme në një sip. 11.025 m<sup>2</sup>. Edhe sikur vendimi i mësipërm të ishte dhënë nga organi kompetent (KKF), kemi të bëjmë me dy shkelje procedurash dhe konkretisht :

- **Është tejkalluar sipërfaqja** që mund të kompensohej një pronar me troje turistike, pasi sipas ligjit nr.8084, datë 07.03.1996, kompensimi fizik mund të kryhej në dy faza për **një sipërfaqe prej jo më të madhe se 10.000 m<sup>2</sup> për të dyja fazat**. Në rastin konkret është kryer kompensim me truall për një sipërfaqe prej 11.025 m<sup>2</sup>, pra 1025 m<sup>2</sup> më tepër se kufiri i lejuar.
- Gjithashtu **në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr.528**, datë 13.05.1996, kompensimi fizik me vendimin nr.58, datë 08.01.1997 është kryer në një fazë ndërkohë që sipas pikës 2, të VKM-së së mësipërme përcaktohej se “Kompensimi me troje në zona turistike do të realizohej në dy faza :“Në fazën e parë kompensimi do të jetë i plotë por jo më shumë se 5000 metra katrorë”. Në fazën e parë përjashtohej pjesëmarrja e disa kategori subjektësh që kanë përfituar kthim prone nga procesi i kthimit të pronës sipas ligjit nr.7698, datë 15.04.1993, apo kanë përfituar pronë

tokë bujqësore nga zbatimi i ligjit nr.7501, 19.07.1991, duke përcaktuar edhe sipërfaqet konkrete të përfitimt në këto raste në më shumë se 5000 m<sup>2</sup> tokë bujqësore apo truall.

**Në Vendimin nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë dhe në tabelën bashkëlidhur tij, nuk parashikohet sipërfaqja konkrete që ish-pronari mund të kishte përfitur nga zbatimi i ligjeve të mësipërme nr.7698, datë 15.04.1993 apo nr.7501, datë 19.07.1991, por vetëm citohet se i njihet e drejta për kompensim për diferencën prej 168 dynym nga diferenca e sipërfaqes ish-pronë e tij, që sipas vendimit është 330 dynym me sipërfaqen që ka përfitur nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 sipas tabelës 1.**

Në tabelën bashkëlidhur nuk parashikohet sipërfaqja e përfitur nga zbatimi i ligjit nr.7501 por po të bëjmë një përlllogaritje të thjeshtë të të dhënave që paraqiten në vendim dhe në tabelë rezulton se subjekti Leko Hodaj ka përfitur përreth **162 dy** tokë bujqësore dhe në këtë mënyrë ai duhej të s'kualifikohej nga faza e parë e kompensimi fizik, me truall në zonat turistike.

Sipas pikës 12, të VKM nr.528, datë 13.05.1996, faza e dytë e kompensimit fizik caktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Po kështu në vazhdim të kësaj llogjike të kundraligjshme dhe aspak ligjore komisioni nuk ka përdorur as edhe formulën e përcaktuar në VKM nr.528, datë 13.05.1996 ,

$$Sk = \frac{Sip. \times C1}{C2}$$

**Ku,**

a) **Sk** është Sipërfaqja që do të jepet për kompensim

b) **Sip** është Sipërfaqja ish pronë

c) **C1** - Sipas rastit (*Çmim i truallit në bazë të ligjit nr.7832, datë 16.06.1994, apo çmimi i tokës bujqësore në bazë të ligjit 7836, datë 22.06.1994, apo Çmimi i kullotave livadheve sipas ligjit përkatës*)

d) **C2** është Çmimi për njësi i truallit që jepet për kompensim.

Pra edhe nëse ky vendim do të ishte dhënë nga organi kompetent (**KKF**), përsëri konstatojmë shkelje të rënda proceduriale dhe materiale në dhënien e tij.

**Së pesti**, referimi ligjor i përdorur nga KKKP në vendimin nr.58, datë 08.01.1997, në bazë të së cilave është bërë kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë që kompensohej fizikisht është **ligji 7980 “Për shitblejrrjen e trojeve” datë 27.7.1996 dhe neni 4** i tij, i cili ka një objekt të ndryshëm nga qëllimi që ka dashur të realizojë komisioni.

**Neni 4 i këtij ligji nuk përputhet dhe as renditet si dispozitë në funksion të procesit të kompensimit fizik. Pra është një dispozitë përdorimin i së cilës nuk legjitimon KKKP të kryejë kompensime fizike me troje në zonat turistike, por as edhe nuk e legjitimon këtë të fundit të kryejë kalimin e pronësisë dhe rregjistrimin automatikisht në zyrat e hipotekës.**

**Së gjashti**, një e metë tjetër e vendimit nr.58, datë 08.01.1997 është se skica bashkëlidhur tij nuk është aspak e saktë nga ana topografike. Nga matjet e bëra sipas skicës së vendimit rezulton se sipërfaqja e vijëzuar e cila është kompensuar fizikisht është **6684 m<sup>2</sup>** dhe jo **11.025 m<sup>2</sup>**, siç është parashikuar në vendim.

**Së shtati**, sipas procedurave të parashikuara në VKM nr.528, datë 13.05.1996 dhe konkretisht në **pikën 9, gërma “f”, “g”, “h”, “i”, “k”, “m”, “n”, “p”** dhe nga shqyrtimi i praktikave nuk rezulton se për nxjerrjen e Vendimit nr.58, datë 08.01.1997, të jenë zbatuar më parë procedurat e hedhjes së shortit dhe llotarisë, si edhe shpallja e fituesit e më pas dhënia e vendimit. Në gërmën “n”, të pikës 9, të VKM-së së mësipërme, konkretisht citohet : “Në përfundim të llotarisë, në prani të noterit dhe të pjesëtarëve të Komisionit të Kompensimit Fizik, prezent në tërheqjen e

Ilotarisë, nënshkruhet një akt i noterizuar në tri kopje, ku të pasqyrohet rezultati i llotarisë. Njëra kopje të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive ose, në rast të mungesës së saj në hipotekë, një në arkivin e Komisionit të Kthimit Fizik dhe njëra do të jetë kopje pune.

Nga shqyrtimi i praktikave të dërguara nga ZVRPP Vlorë, rezulton se bashkëlidhur vendimit nuk egziston një akt i noterizuar, ku të pasqyrohet rezultati i llotarisë, ç'ka provon se asnjë nga procedurat e parashikuara në pikën 9, të VKM nr.528, datë 13.05.1996, nuk është zbatuar nga KKKP. Vetëm pas hedhjes së llotarisë dhe shpalljes së fituesit, atëherë zbardhej vendimi për kompensimin fizik të ish-pronarit. Pra përsëri edhe nëse vendimi nr.58, datë 08.01.1997, do të ishte dhënë nga organi kompetent, përsëri kemi të bëjmë me **shkelje të rënda të procedurave të shpërndarjes së kompensimit fizik.**

Së teti, në kundërshtim me pikën 6, të VKM nr.528, datë 13.05.1996, rezulton se në dhënien e Vendimit nr.58, datë 08.01.1997 nuk është zbatuar drejt çmimi i tokës që kompensohej dhe as koficientët respektiv sias zonave të parashikuara në këtë vendim. Në zbatim të kësaj VKM-je çmimi për efekt të përlllogaritjes së truallit që kompensohej me tokën e ish-pronarit ishte **3200 lekë dhe jo 320 lekë, çmim ky që është përdorur në Vendimin nr.58, datë 08.01.1997, të KKKP-së Vlorë, të ankimuar.**

Së nënti, vendimi 58 është në kontradiktë kronologjike protokollimi me numrat e vendimeve të tjera të marra nga KKKP e rrethit Vlorë. Konkreisht **Vendimi nr.58**, rezulton të jetë marrë më datë **08.01.1997**, ndërsa **Vendimi me nr.42**, daton më **08.02.1997** dhe **Vendimi nr.39**, daton më **04.02.1997**. Kjo parregullsi të krijon bindjen se këto vendime nuk janë marrë sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara, në aktet nënligjore për funksionimin e KKKP, si edhe faktin që dihet botërisht se në datat kur mund të jetë marrë ky vendim rrethi i Vlorës ishte nën prag të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme.

**Për gjithë sa konstatojmë më sipër, vlerësojmë se :**

**Vendimi nr.58, datë 08.01.1997 i marrë nga KKKP Vlorë** është marrë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe aktet nënligjore që përcaktojnë organet përkatëse dhe procedurën e realizimit të kompensimit fizik, e për rrjedhojë ankimimi i paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe Bashkia Vlorë, janë të bazuara në ligj e në prova dhe në këtë mënyrë ato duhen pranuar.

Ky akt përveç sa më sipër është marrë jo vetëm në kapërcim të kompetencave lëndore nga KKKP Vlorë, por ai njëkohësisht është marrë në kundërshtim edhe me procedurat dhe formën e kërkuar nga ligji.

Në këtë mënyrë në zbatim të **nenit 21 të Kodit të Procedurave Administrative** dhe parimeve të përcaktuara në këtë Kod çmujmë se, kompetencat e Organeve të Administratës Publike janë të përcaktuara me ligj ose akt nënligjor dhe ushtrimi i tyre është i detyrueshëm. Pra sipas parimit kushtetues të ligjshmërisë, çdo organ administrativ është kompetent në fushën që ai mbulon dhe nuk mund të ushtrojë të drejtat e një organi tjetër, pasi ushtrimi përtej kufijve të ligjit përbën cënim të parimit të mësipërm dhe si rrjedhim çdo veprim apo akt administrativ që mund të nxirret nga kjo veprimtari e kufizuar dhe arbitrare çon domosdoshmërisht në **pavlefshmeri juridike të tyre**

Ushtrimi i pushtetit adminstrativ në respektim të kompetencave lëndore e tokësore është i lidhur ngushtë me të drejtën dhe njëkohësisht detyrimin e çdo organi adminstrativ **për të vepruar vetëm brenda hapsirës së çështjeve dhe kufijve tokësorë të njohur dhe të sanksionuar nga ligji material.**

Mbështetur në sa më sipër dhe duke iu referuar nenit 116 pika “b”, të K.Pr.A , ky vendim **nr.58 datë 08.01.1997 i KKKP-së Vlorë, konstatohet si absolutisht i pavlefshëm**, sepse është një akt i nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore dhe si i tillë nuk prodhon pasojë sepse është ‘nul’ që nga fillimi, pasi tejkalimi i kompetencave përbën në vetvete ‘inkompetencë’ të këtij organi (KKKP). **Në këtë kontekst theksojmë se aktet administrative absolutisht të pavlefshme për shkak të shkeljes thelbësore të ligjeve nuk e kanë fuqinë juridike të një akti administrativ të vlefshëm.**

Organet administrative gjatë manifestimit të vullnetit të tyre në këtë rast KKKP në ushtrimin e funksioneve administrative, përmes nxjerrjes së aktit administrativ, janë të detyruara jo vetëm të veprojnë brenda kufijve të kompetencave lëndore dhe tokësore të njohura nga ligji, por edhe në respektim të procedurave që garantojnë një proces të ligjshëm administrativ vendimarrës. **Në rastin konkret asnjë nga procedurat e kërkuara nga aktet ligjore e nënligjore që rregullonin realizimin e shpërndarjes së kompensimit fizik nuk është respektuar.** Pra edhe në referim të pikës “c” të nenit 116, të K.Pr.A Vendimi nr.58, datë 08.01.1997 i KKKP-së Vlorë, **konstatohet si absolutish i pavlefshëm.**

**Gjithashtu theksojmë se konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ mund të bëhet nga palët e interesuara dhe organi administrativ kompetent në çdo kohë dhe konstatimi i kësaj pavlefshmërie nuk lidhet me ndonjë afat.**

**Në rastin e Vendimit nr.58, datë 08.01.1997, KKKP Vlorë ka vepruar në kapërcim të kompetencave dhe nuk ka respektuar as procedurën e kërkuar qoftë gjatë apo pas nxjerrjes së aktit, veprime këto të cilat përbëjnë shkelje flagrante të ligjit, dhe që çojnë detyrimisht në pavlefshmeri absolute të këtij vendimi, i cili duhet të konstatohet nga AKKP, duke bërë kështu anullimin e tij në kuptim të nenit 115, 116 dhe 117 të K.Pr.A.**

Bazuar në sa më sipër, në zbatim të nenit 16, pika “c” dhe pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, si dhe neneve 115/a, 116/b,c, 117 të Kodit të Procedurave Administrative, Ju propozojmë marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me këto kërkesa ankimore ku të vendosni: **“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr.58, datë 08.01.1997 të KKKP Vlorë dhënë në favor të subjektit Leko Hodaj dhe rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura”.**

Tiranë, më 20.03.2007

**Në pritje të miratimit përfundimtar nga ana Juaj .**

Shqyrtoi dhe vlerësoi: Grupi i Punës	Bledar Dervishaj	Jurist
	Eglantina Rizvanolli	Inxhinierë
	Drini Çano	Jurist

**Mbikqyri dhe pranoi:** Shefi i Sektorit të Apelit  
Ridvan Shkëmbi

**MIRATOI**

**Drejtor i Përgjithshëm**

**Justina BORIÇI**